

INTEGRITETI GJYQËSOR

MANUAL TRAJNIMI PËR SHOQËRINË CIVILE

Standardet ligjore, parimet deontologjike,
sistemi i vlerësimit dhe i disiplinimit

Manual 1

Tiranë, Shtator 2023

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.



Funded by
the European Union

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Gjyqësori në fokus” i zbatuar nga një konsorcium prej tre partnerësh: Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Centre for Legal Empowerment (CLE), me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021”.

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Institutit për Studimet Publike & Ligjore dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit Evropian.

©Të gjitha të drejtat e botimit i takojnë Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL)

ISBN: 9789928361516

SHKURTIME

GjK	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
GjEDNj	Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut
KL Gj	Këshilli i Lartë Gjyqësor
NjABGj	Njësia e administrimit të buxhetit gjyqësor, pranë KL Gj-së
ILD	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
ShM	Shkolla e Magjistraturës
ENCJ/RREKGj	Rrjeti Europian i Këshillave Gjyqësorë
GJIN/RRBIGj	Rrjeti Botëror i Integritetit Gjyqësor (Global Judicial Integrity Network)
CCJE	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Europianë
UNCAC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin e Organizuar
GRECO	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit i Këshillit të Europës
KPC	Kodi i Procedurës Civile
KPP	Kodi i Procedurës Penale

Pasqyra e lëndës

SHKURTIME	3
PËRMBLEDHJE.....	7
OBJEKTIVAT DHE REZULTATI QË SYNOHET TË ARRIHET	9
STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E TRAJNIMIT.....	10
PLANI I TRAJNIMIT.....	11
MODULI 1	
KUADRI LIGJOR VENDAS DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE.....	13
MODULI 2	
PARIMET DEONTOLOGJIKE NË PRAKTIKËN E GJYKATAVE SHQIPTARE (Parimet themelore gur themeli për parimin themelor të ndarjes dhe balancës së pushteteve të sanksionuar nga Kushtetuta e Shqipërisë).....	17
1. Parimet deontologjike që udhëheqin sjelljen gjyqësore të gjyqtarëve.....	17
2. Parimi i Transparencës	18
3. Pavarësia institucionale e gjyqësorit	18
4. Pavarësia personale dhe paanësia e gjyqtarëve	18
5. Parashikueshmëria e vendimeve gjyqësore, siguria juridike dhe standardet e të gjykuarit.....	19
6. “Imunizimi” socio-politik i gjyqësorit.....	19
7. Indikatorët e performancës	19
MODULI 3	
SISTEMI I VLERËSIMIT TË GJYQTARËVE TË EMËRUAR NË DETYRË SI DHE STANDARDET E PERFORMANCËS SË GJYQTARIT.....	24
Indikatorët e performancës.....	27
Metoda e matjes.....	28
EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI PËRKATËS.....	29
RASTE STUDIMORE	31
BIBLIOGRAFI	34

PËRMBLEDHJE

Ky manual trajnimi është hartuar në kuadër të projektit “Judiciary under spotlight”, i zbatuar nga konsorciumi prej tre partnerësh: Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Centre for Legal Empowerment (CLE) me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021” nën IPA III/2022/441-466. Manuali vjen si një vijimësi e Guidës së Monitorimit për Shoqërinë Civile “Integriteti Gjyqësor”, e hartuar me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për procesin e ushtrimit të veprimtarisë nga gjyqësori, si një prej tri pushteteve të pavarura, konsolidimi i të cilit është kusht i domosdoshëm për forcimin e shtetit të së drejtës. Përfshirja e shoqërisë civile në mekanizmat e kontrollit dhe llogaridhënies është tregues i rëndësishëm i qeverisjes së mirë dhe i demokracisë së një vendi. Kjo mundësohet përmes mekanizmave të ndryshëm, një prej të cilëve është edhe ushtrimi i studimeve monitoruese nga shoqëria civile. Në vijim të treguesve dhe faktorëve të përcaktuara nga Guida, ky Manual synon të analizojë në mënyrë të detajuar standardet, kriteret dhe procedurat që kanë të bëjnë me pavarësinë, kompetencën dhe përkushtimin e gjyqtarit ndaj vlerave profesionale, si parakushte që gjyqësori të performojë me standardet e duhura në përmbushjen e funksionit të tij në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit dhe dhënies së drejtësisë në një shoqëri demokratike.

Manuali i Trajnimit është i organizuar në module për aspekte të ndryshme të trajtimit të integritetit gjyqësor. Në këtë aspekt, përmes këtij manuali trajnues do të analizohen në mënyrë të detajuar sa vijon:

- Standardet ndërkombëtare dhe kuadri ligjor dhe strategjik i Shqipërisë për integritetin gjyqësor;
- Monitorimi i zbatimit të parimeve deontologjike në praktikën e gjykatave shqiptare: Standardet e performancës dhe institucionet përgjegjëse; Treguesit e performancës dhe metodologjia për mbledhjen e të dhënave përkatëse;
- Monitorimi i zbatimit të regjimit disiplinor për magjistratët në detyrë dhe ndikimi i tij në integritetin e gjyqësorit: Standardet e performancës dhe institucionet përgjegjëse; Treguesit e performancës dhe metodologjia për mbledhjen e të dhënave përkatëse.

Standardet ndërkombëtare, kuadri ligjor i brendshëm, jurisprudenca përkatëse e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe e Gjykatës Kushtetuese janë parësore të njihen për të pasur njohuritë e nevojshme mbi bazën e rregullave dhe parimeve mbi të cilat

gjqësori realizon veprimtarinë e vet. Për këtë, një pasqyrim dhe trajtim i plotë i mënyrës se si interpretohen dhe zbatohen kriteret ligjore e nënligjore nga organet përkatëse është i domosdoshëm. Përmes manualit do të trajtohet kuadri ligjor në fuqi në vend, duke filluar nga Kushtetuta, aktet ligjore dhe nënligjore, strategjia e drejtësisë në fuqi dhe dokumente të tjera sipas rastit dhe posaçërisht parime themelore deontologjike për gjyqësorin. Do të trajtohen standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë ato të organizatave të ndryshme, jurisprudenca. Në këtë pjesë vëmendja përqendrohet në standardet për rëndësinë e integritetit gjyqësor për mbarëvajtjen e të gjithë sistemit gjyqësor.

Po ashtu, trajtimi i regjimit disiplinor për magjistratët në detyrë dhe ndikimi i tij në integritetin e gjyqësorit është parësor si një ndër aspektet llogaridhënëse, kontrolluese dhe ndëshkuese të magjistratëve për sa puna e tyre lidhet me zbatimin e rregullave dhe detyrimeve ligjore. Standardet e performancës dhe institucionet përgjegjëse, si dhe treguesit e performancës dhe metodologjia për mbledhjen e të dhënave përkatëse janë me rëndësi të njihen dhe të zbatohen saktë nga shoqëria civile, me qëllim që ajo të ushtrojë rolin e saj mbikqyrës dhe ushtrues, presionin për përmirësimin e performancës së vetë gjyqësorit. Qëndrime të shoqërisë civile mbi të dhëna të sakta që pasqyrojnë sa kërkesat ligjore, aq edhe zbatimin e tyre të saktë në praktikë, vetëm rrisin legjitimitetin e kësaj të fundit si mekanizëm kontrolli ndaj pushtetit gjyqësor.

OBJEKTIVAT DHE REZULTATI QË SYNOHET TË ARRIHET

Qëllimi i përgjithshëm i këtij manuali është t'u bëjë të mundur pjesëmarrësve që të përmirësojnë njohuritë dhe të kuptuarit mbi kuadrin vendas dhe ndërkombëtar që lidhet me integritetin e pushtetit gjyqësor. Përveç kësaj, ai do të aftësojë pjesëmarrësit që të njohin standardet lidhur me disiplinën dhe masat që merren ndaj gjyqtarëve. Përmes këtij moduli trajnimi, konkretisht synohet ofrimi i asistencës teknike dhe i trajnimeve për shoqërinë në lidhje me integritetin e gjyqësorit.

Synohet fuqizimi i OSHC-ve në monitorimin me efektivitet të organizimit dhe funksionimit të gjyqësorit në vendin tonë. Moduli i trajnimit synon të fuqizojë shoqërinë civile dhe aktorët e tjerë për të zhvilluar monitorimin dhe vlerësimin e gjyqësorit, si dhe ushtrimin e veprimtarisë së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Integriteti përfshin një sërë aspektesh të organizimit dhe të funksionimit të gjyqësorit, përfshirë një sërë aftësish të gjyqtarëve, si profesionale ashtu edhe morale në ushtrimin e detyrës. Termat e ndryshëm të legjislacionit dhe mënyra se si janë interpretuar e zbatuar është e nevojshme të kryhet për qëllime të këtij trajnimi. Vendimi se çfarë duhet të monitorohet dhe pse është e vlefshme, ndihmon për të përcaktuar të dhënat që duhet të mblidhen dhe të analizohen.

Modulet e trajnimit, si të gjitha ato të hartuara për integritetin gjyqësor, synojnë:

- Njohjen e qëllimeve dhe përmbajtjes së parimeve ndërkombëtare dhe kombëtare për sjelljen e gjyqtarit.
- Trajtimin e standardeve të performancës, treguesit e realizimit për secilin nga standardet, metodat e matjes së realizimit të tyre, duke përfshirë të dhënat që duhen mbledhur; indikatorët cilësorë dhe/ose sasiorë (ku zbatohen) duke u përqendruar në ato thelbësore; burimin e të dhënave dhe mënyrën e mbledhjes së tyre.
- Rritjen e aftësisë për të dalluar sjelljet gjyqësore dhe etike që çojnë në mungesën e integritetit.
- Kuptimin bazë të rolit të shoqërisë civile në këtë sistem.

Aktorët e shoqërisë civile synojnë të përfitojnë aftësitë e duhura për të ndërmarrë nisma në kuadër të llogaridhënies efektive, rritjes së përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve të drejtësisë dhe përmirësimit të legjislacionit, për monitorimin e respektimit të parashikimeve ligjore që garantojnë integritetin e gjyqtarit dhe rrisin besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E TRAJNIMIT

MODULI 1	<p>Kuadri ligjor Kuadri ligjor vendas - Kushtetuta - Aktet ligjore dhe nënligjore - Reforma në drejtësi dhe strategjia e saj</p> <p>Standardet kombëtare dhe ndërkombëtare 1. Standardet e organizatave ndërkombëtare. 2. Opinione dhe rekomandime të organizmave ndërkombëtare. 3. Jurisprudenca e GjEDNj-së. 4. Gjykata Kushtetuese. Në këtë pjesë vëmendja përqendrohet edhe në rëndësinë e integritetit gjyqësor për mbarëvajtjen e të gjithë sistemit gjyqësor. 5. Indikatorët e performancës.</p>
MODULI 2	<p>Parimet themelore gur themeli për parimin themelor të ndarjes dhe balancës së pushteteve të sanksionuar nga Kushtetuta e Shqipërisë 1. Parimet deontologjike që udhëheqin sjelljen gjyqësore të gjyqtarëve. 2. Parimi i Transparencës. Pavarësia institucionale e gjyqësorit. 3. Pavarësia personale dhe paanësia e gjyqtarëve. 4. Parashikueshmëria e vendimeve gjyqësore, siguria juridike dhe standardet e të gjykuarit. 5. “Imunizimi” socio-politik i gjyqësorit. 6. Indikatorët e performancës.</p>
MODULI 3	<p>Standardet disiplinore për gjyqësorin; vlerësimi dhe matja 1. Regjimi disiplinor. 2. Përgjegjësia ligjore (penale dhe civile) e gjyqtarëve. 3. Integriteti në vendimmarrje dhe ndershmëria e drejtimit të procedurave. 4. Indikatorët e performancës.</p>

Të gjitha modulet ndjekin rrugën e njëjtë: trajtohet monitorimi i standardeve të performancës, treguesit e realizimit për secilin nga standardet, metoda e matjes së realizimit të tyre duke përfshirë të dhënat që duhen mbledhur; indikatorët sasiorë dhe/ose cilësorë duke u përqendruar në ato thelbësorët, metodën e matjes, të dhënat e nevojshme që duhet mbledhur për matjen e indikatorit, mënyrën e mbledhjes së tyre dhe burimin e të dhënave.

PLANI I TRAJNIMIT

Prezantimi i manualit sipas moduleve të strukturuar si më lart mund të realizohet në një kohëzgjatje 2 orë, sipas tabelës së mëposhtme:

Aktiviteti	Metoda	Kohëzgjatja
<p>Hyrja: Prezantimi i qëllimit dhe organizimi i trajnimit. Pritshmëritë.</p>	Prezantim	10 minuta
<p>Kuadri ligjor vendas dhe standardet ndërkombëtare (Moduli 1)</p> <p>Gjatë këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me aktet ndërkombëtare, legjislacionin e brendshëm, standardet e organizatave ndërkombëtare, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të GjEDNj-së, e cila përqendrohet në rëndësinë e integritetit gjyqësor për mbarëvajtjen e të gjithë sistemit gjyqësor. Gjithashtu në këtë modul do të prezantohen edhe opinione dhe rekomandime që lidhen me integritetin e gjyqtarit. Ky modul trajton edhe indikatorët sasiorë dhe/ose cilësorë për matjen e performancës lidhur me kuadrin ligjor.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/raste gjyqësore për diskutim</p>	30 minuta
<p>Parimet deontologjike në praktikën e gjykatave shqiptare (Moduli 2)</p> <p>Me anë të këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me parimet themelore të integritetit të gjyqësorit dhe gjyqtarëve. Do të trajtohen në mënyrë të detajuar pavarësia dhe paanshmëria me elementet e tyre mishëruese. Në këtë modul do të trajtohet edhe natyra e kontrollit të këtyre parimeve dhe treguesit e realizimit të monitorimit, si dhe indikatorët sasiorë dhe/ose cilësorë për matjen e performancës deontologjike në praktikën e gjykatave shqiptare.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/raste gjyqësore për diskutim</p>	40 minuta

<p>Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve të emëruar në detyrë si dhe standardet e performancës së gjyqtarit</p> <p>(Moduli 3)</p> <p>Me anën e këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me standardet e performancës së gjyqtarëve dhe regjimin disiplinor për gjyqtarët, përfshirë treguesit e performancës për aspektet deontologjike të gjyqtarit.</p>	<p>Prezantim me powerpoint Realizimi i diskutimeve interaktive/ raste gjyqësore për diskutim</p>	<p>40 minuta</p>
---	--	------------------

MODULI 1

KUADRI LIGJOR VENDAS DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE

1. Standardet e organizatave ndërkombëtare; dhe 2. Opinione dhe rekomandime të organizmave ndërkombëtare

- Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm thekson rolin qendror të institucioneve transparente, efektive dhe të përgjegjshme në promovimin e shoqërive paqësore, të drejta dhe gjithëpërfshirëse dhe rëndësinë e dhënies së drejtësisë për të gjithë.
- Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit kërkon që shtetet palë të marrin masa për të forcuar integritetin dhe për të parandaluar mundësitë për korrupsion midis anëtarëve të gjyqësorit.¹
- Deklarata e Dohas e vitit 2015, e miratuar nga Kongresi i Trembëdhjetë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe të Drejtësisë Penale, riafirmoi përkushtimin dhe vullnetin e fortë politik të shteteve në mbështetje të sistemeve të efektshme, të drejtë, njerëzore dhe të përgjegjshme të drejtësisë penale dhe institucioneve që i përbëjnë ato.
- Parimet e Sjelljes Gjyqësore të miratuara nga ECOSOC, Res. 2006/23, Bangalore, njohur si Parimet e Bangalorit, janë një instrument me vlerë të madhe si për gjyqësorin ashtu edhe për publikun e gjerë dhe për të gjithë ata që janë të interesuar të vendosin një themel të fortë për një gjyqësor global me integritet të paprekshëm.

Lista e akteve ndërkombëtare

- Parimet themelore për pavarësinë e gjyqësorit. Miratuar në Kongresin e Shtatë të OKB-së, Milano, 1985;
- Deklarata e Pekinit për Parimet e Pavarësisë së Gjyqësorit në Rajonin LAWASIA. Pekin, 19 gusht 1995;
- Parimet e Commonwealth (Latimer House) mbi Tri Degët e Qeverisë;
- Projekt Parimet për Pavarësinë e Gjyqësorit - "Parimet e Sirakuzës";
- ECOSOC, Forcimi i Parimeve Bazë të Sjelljes Gjyqësore, 2006/23;
- Programi Global Kundër Korrupsionit, Forcimi i Integritetit Gjyqësor kundër Korrupsionit, 2001 Samiti Ibero-Amerikan i Presidentëve të Tribunaleve të Lartë të Drejtësisë dhe Gjykatave Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve;

1. Neni 11 i Konventës së OKB kundër Korrupsionit "*Duke pasur parasysh pavarësinë e gjyqësorit dhe rolin e saj të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, çdo Shtet Palë, në përputhje me parimet themelore të sistemit të saj ligjor dhe pa paragjykuar pavarësinë e gjyqësorit, merr masa për të forcuar integritetin dhe për të parandaluar mundësitë për korrupsion mes anëtarë të gjyqësorit. Masa të tilla, mund të përfshijnë rregulla në lidhje me sjelljen e anëtarëve të gjyqësorit*".

- Parimet Ndërkombëtare për Pavarësinë dhe Përgjegjshmërinë e Gjyqtarëve, Avokatëve dhe Prokurorëve. Udhëzuesi i praktikuesve nr. 1, 2007;
- Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve, Përgjegjshmëria Gjyqësore - Udhëzues për praktikuesit, 2016;
- Masat për zbatimin efektiv të Parimeve Bangalore të Sjelljes Gjyqësore;
- Opinioni nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE). Strasburg, 19 nëntor 2002;
- Plani i Veprimit për Afrikën mbi Parimet e Komonuelthit mbi Përgjegjshmërinë dhe Marrëdhëniet Midis Tri Degëve të Qeverisë;
- Rekomandimi Nr. R (94) 12 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare të Pavarësisë, Efiçencës dhe Rolit të Gjyqtarëve. Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 13 tetor 1994 në mbledhjen e 518-të të Zëvendës Ministrave;
- Deklarata e Kajros për Pavarësinë Gjyqësore;
- Komentari mbi Parimet e Bangalore të Sjelljes Gjyqësore;
- Deklarata e Stambollit mbi Transparencën në Procesin Gjyqësor;
- Karta Universale e Gjykatësit Transparency International, Raporti Global i Korrupsionit 2007: Korrupsioni në Sistemin Gjyqësor, 2007;
- Transparency International Rumania, Rritja e Aftësisë së Gjyqësorit për të frenuar korrupsionin - Një udhëzues praktik, 2015;
- U4 dhe UNDP, Një gjyqësor transparent dhe i përgjegjshëm për të ofruar drejtësi për të gjithë, 2016 UNODC, Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit - Udhëzuesi i Zbatimit dhe Korniza Vlerësuese për Nenin 11, 2015;
- UNODC, Udhëzuesi i Burimeve për Forcimin e Integritetit dhe Kapacitetit Gjyqësor, 2011
- Rezolutë e Këshillit të Evropës për Etikën në Gjyqësor, 21 qershor 2021, https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Resolution_Judicial_Ethics_ENG
- Opinion No. 21 "Preventing corruption among judges", <https://www.coe.int/en/web/ccje/judicial-integrity-and-corruption>

3. Jurisprudenca e GjEDNj-së

- *Stafford vs. the United Kingdom*, No. 46295/99, 2002: GjEDNj thekson se rëndësia e pavarësisë dhe e paanshmërisë së pushtetit gjyqësor, tashmë dy parime edhe të së drejtës ndërkombëtare, po pëson rritje të vazhdueshme në kuptimin e gjyqësisë bashkëkohore;
- *Kyprianou vs. Cyprus*, decision of the Grand Chamber of 15 December 2005: GjEDNj thekson se nuk ka një ndarje të theksuar mes paanësisë objektive dhe subjektive, pasi e njëjta situatë ose sjellje e një gjyqtari mund të shkaktojë shqetësime në sytë e një vëzhguesi (testi objektiv) dhe po ashtu mund t'u japë shkas dyshimeve rreth bindjeve personale të gjyqtarit (testi subjektiv)
- *Vardanyan & Nanushyan kundër Armenia*, vendim i 27 Tetorit 2016: GjEDNj vuri në pah se përdorimi i gjuhës nga gjyqtari gjatë seancës ishte në gjendje të shkaktonte

frikën legjitime se refuzimi i kërkesit për të pranuar një ofertë për marrëveshje miqësore, mund të kishte efekt negativ mbi shqyrtimin nga gjykata të themeleve të çështjes së tij.

- *Sigríður Elín Sigfúsdóttir vs. Iceland*, 25 shkurt 2020: GjEDNj vë në pah se gjyqtari duhet të vërë në vëmendje të palëve çështjen e lidhjes së gjyqtarit me çështjen apo palët, për t'u lejuar atyre që ta kontestojnë pjesëmarrjen e tij në gjykim, etj.
- *Filippini kundër San Marino*, GjEDNj u shpreh se, megjithëse simpatitë politike luajnë rol në procesin e emërimit, kjo është e pamjaftueshme për të ngritur dyshime lidhur me pavarësinë dhe me paanshmërinë e gjyqtarëve. Ajo që ka rëndësi për GjEDNj-në është fakti se nuk duhet të ketë orvatje për të influencuar gjyqtarët pas emërimit të tyre.

4. Ligje të vendit dhe Vendime të Gjykatës Kushtetuese

Ndër ligjet themelore të kuadrit ligjor vendas përfshihen:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” Ligji nr.95/2016;
- Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve” (Ligji nr.96/2016);
- Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr.98/2016);
- Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (Ligji nr.115/2016);
- Ligji nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Shqipërisë”, i ndryshuar
- Kodi i Etikës Gjyqësore (2021).

Ligji nr. 96/2016 “Mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka vendosur kriteret dhe procedurat për: (1) përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve; (2) ushtrimin dhe përfundimin e mandatit të gjyqtarëve; (3) vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve; (4) përgjegjësinë disiplinore, detyrimet penale dhe civile të gjyqtarëve. Ai përfshin rregulla për: pavarësinë gjyqësore, vlerat e përgjithshme dhe të drejtat e magistratëve për të vazhduar trajnimin, mbështetjen financiare, përfitime të tjera për gjyqtarët, trajnimin fillestar, emërimin e magistratëve, transferimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, vlerësimin e gjyqtarëve, detyrimet disiplinore, penale dhe civile të gjyqtarëve.

Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” përfshin dispozita për organet qeverisëse të drejtësisë: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe Shkolla e Magjistraturës, si institucione të paanshme e të pavarura nga asnjë ndikim i jashtëm.

Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar më 10.06.2016, rregullon organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor në Shqipëri bazuar në parimet e ligjshmërisë, pavarësisë, paanësisë, së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës, shërbimit gjyqësor dhe statusit të nëpunësve civilë gjyqësorë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor i Republikës së Shqipërisë, bazuar në standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, miratoi Vendimin nr. 171, datë 22.04.2021, Kodin e Etikës Gjyqësore. (Fletore Zyrtare nr.66, datë 29/04/2021)

5. Treguesit

Tregues të këtij moduli janë të lidhur me zbatimin e standardeve ndërkombëtare në vend, sikurse pasqyrimi i këtyre standardeve në kuadrin ligjor të brendshëm. *Metoda e matjes së këtij treguesi është vlerësimi analitik i hapësirave ligjore.* Kjo kërkon të:

- 1) identifikohet lista e standardeve ndërkombëtare;
- 2) identifikohet kuadri ligjor vendas për integritetin e gjyqësorit; dhe
- 3) mund të vendosen në formë tabelare rregullat ndërkombëtare përkundrejt rregullave që kanë pasqyruar ato.

Të dhënat e nevojshme për këtë tregues mblidhen në:

- Fletore Zyrtare: Kushtetuta, ligjet, aktet nënligjore, vendime të Gjykatës Kushtetuese;
- Faqen zyrtare të KLGj-së dhe KLP-së: vendime që lidhen me integritetin gjyqësor.

Matja e treguesit realizohet përmes hartimit të një Raporti të Analizës së Hapësirave Ligjore të harmonizimit të kuadrit ligjor vendas me standardet ndërkombëtare.

Shënim:

Një shembull i një vlerësimi konciz të kuadrit ligjor në fuqi gjendet në: https://crd.org/wp-content/uploads/2021/03/210222_PolicyPapers_ALB_FIN.pdf

MODULI 2

PARIMET DEONTOLOGJIKE NË PRAKTIKËN E GJYKATAVE SHQIPTARE

(Parimet themelore gur themeli për parimin themelor të ndarjes dhe balancës së pushteteve të sanksionuar nga Kushtetuta e Shqipërisë)

1. Parimet deontologjike që udhëheqin sjelljen gjyqësore të gjyqtarëve

Etika e gjyqtarit shkon përtej rregullave ligjore. Megjithatë, ka një unanimitet opinioni mbi thelbin e parimeve bazë të profesionit të gjyqtarit, pavarësisht diferencave, mbi të cilat ai duhet të veprojë: pavarësia, paanësia, integriteti, përshtatshmëria, barazia, kompetenca dhe kujdesi i duhur.² Pavarësisht se nuk ka norma morale dhe etike të kodifikuara dhe universale për gjyqtarët, ka një proces të vazhdueshëm globalisht që: afirmon të drejtën ndërkombëtare, sidomos mbi të drejtat e njeriut; harmonizon praktikën gjyqësore sidomos mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin; bën përpjekje për unifikim të edukimit ligjor të gjyqtarëve mbi zbatimin e të drejtës ndërkombëtare dhe kombëtare. Me rritjen e rëndësisë së rolit të gjyqtarit në shoqëri, po rritet gjithashtu dhe nevoja për kodifikim të deontologjisë së këtij profesioni.³

Gjyqtarët duhet të udhëhiqen në veprimtarinë e tyre nga parime të sjelljes etike dhe profesionale. Këto parime jo vetëm që përfshijnë detyrat, shkelja e të cilave mund të shkaktojë masa disiplinore, por ofrojnë edhe udhëzime për gjyqtarët sesi duhet të sillen. Këto parime janë shtjelluar në kodin e etikës gjyqësore, i miratuar nga KLGj-ja në vitin 2021. Sipas Kodit të Etikës, parimet bazë të etikës janë:

- o Parimi i Pavarësisë;
- o Parimi i Paanshmërisë;
- o Parimi i Integritetit;
- o Parimi i Sjelljes së Hijshme dhe me Vetëpërmbytje;
- o Parimi i Kujdesit të Duhur dhe Profesionalizmit;
- o Parimi i Respektit dhe Aftësisë për të Dëgjuar;
- o Parimi i Trajtimit të Barabartë;
- o Parimi i Transparencës.

2. Profesionit të gjyqtarit, Rrjeti i Lisbonës, Këshilli i Europës. https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/lisbonnetwork/themis/Ethics/Paper2_en.asp

3. Parimet Bangalore të sjelljes gjyqësore [*The Bangalore Principles of judicial conduct*], të konfirmuara përmes Rezolutës 2006/23, vendosin standarde etike të sjelljes gjyqësore dhe përpunojnë parimet e pavarësisë, paanshmërisë, dinjitetit, barazisë, kompetencës dhe rregullsisë së gjyqtarëve.

2. Parimi i Transparencës

Transparenca administrative është çështje politike dhe ligjore. Si çështje ligjore ajo i referohet “të drejtës të palëve dhe të publikut në përgjithësi për të njohur/ditur” çfarë ndodh brenda procedurave gjyqësore, por edhe se si administrohet pushteti gjyqësor, se si ushtrohet pushteti gjyqësor, si një nga tri pushtetet publike kushtetuese.⁴ Ajo pasqyrohet përmes elementeve si:

- *Aksesi në një drejtësi cilësore, komunikimi me përdoruesit e gjykatave dhe publikun;*
- *Aksesi i publikut dhe shtypit/mediave në procedurën gjyqësore dhe në sallat/ambientet gjyqësore;*
- *Aksesi në vendimet gjyqësore (arkivat, data-base) dhe informacione të tjera të lidhura me gjykatën;*
- *Arsyetimi i vendimeve gjyqësore;*
- *Gjenerimi i informacioneve dhe zgjidhja efektive e problemeve të pjesëmarrjes, për palët, publikun dhe shtypin.*

3. Pavarësia institucionale e gjyqësorit

Pavarësia e gjyqësorit duhet kuptuar si *pavarësi thelbësore* (tagër e gjykatave për të dhënë vendime me paanësi dhe pa u ndikuar nga interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit) dhe si *pavarësi strukturore*. Si pjesë të pavarësisë strukturore konsiderohen njëkohësisht edhe *pavarësia organizative* dhe *financiare*⁵. Kushtetuta ka sanksionuar vetëqeverisjen e gjyqësorit, përmes Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë⁶.

4. Pavarësia personale dhe paanësia e gjyqtarëve

Gjyqtarët u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Është e një rëndësie themelore në një shoqëri demokratike që gjykatat të frymëzojnë besim te publiku dhe, mbi të gjitha, te palët në proces. Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke zbatuar **testin objektiv**, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë dhe **testin subjektiv**, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose të interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar. Nga pikëpamja e testit objektiv të paanshmërisë, kur shqyrtohet nëse në një çështje të caktuar ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm⁷.

4. Konventa e Këshillit të Evropës për Aksesimin e dokumenteve zyrtare, 18/06/2009.

5. Vendimi nr. 25, datë 05.12.2008 i Gjykatës Kushtetuese.

6. Neni 147/1 i Kushtetutës.

7. Vendimet: nr.7, datë 11.03.2008; nr.11, datë 02.04.2008; nr.23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

5. Parashikueshmëria e vendimeve gjyqësore, siguria juridike dhe standardet e të gjykuarit

Siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve publike, përfshirë vendimet gjyqësore, që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme.

6. “Imunizimi” socio-politik i gjyqësorit

Imunizimi “socio-politik” është i lidhur me pavarësinë edhe paanësinë e gjyqësorit si pushtet, por dhe gjyqtarit si funksionar publik. Imunizimi struktural i gjyqësorit është kusht i rëndësishëm për pavarësinë e gjyqësorit. Imunizimi i gjyqtarit duhet konsideruar si *kusht sine qua non* në këtë drejtim. Një gjyqtar mund të ndikohet gjatë punës së tij, nga aktorë të jashtëm, si organizata dhe grupe të ndryshme interesi, por edhe nga brenda sistemit, nga kolegë ose nga gjyqtarë me karrierë më të sukseshme, në pozicion gjyqtari në gjykatat më të larta. Gjyqtari nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. Gjyqtari duhet të marrë çdo masë për të qenë, dhe të duket se është, jashtë çdo ndikimi prej tyre. Gjyqtari njofton menjëherë Këshillin (KLGj), dhe kryetarin, në rast se evidenton ndërhyrje ose ushtrim të ndikimit të papërshtatshëm ndaj tij. Imunizimi ka lidhje me parakushtet formale dhe substanciale, institucionale dhe personale të natyrës ligjore, ekonomike, sociale dhe familjare, që i mundësojnë gjyqtarit të ushtrojë detyrën, dhënien e drejtësisë i pandikuar, i pavarur, dhe jo në konflikt interesi, sipas standardeve të Kartës Europiane të Statusit të Gjyqtarit, të Këshillit të Europës, 1998, si dhe Memorandumit Shpjegues të Kartës.

7. Indikatorët e performancës

Pavarësia institucionale e gjyqësorit mund të vlerësohet përmes treguesve të realizimit për standardet e pavarësisë thelbësore, organizative dhe financiare për të cilat mund të shtroheshin pyetje, si:

- Mekanizmat e duhur të mbrojtjes së pavarësisë së gjyqësorit në Këshillin e Lartë Gjyqësor: a ka të tilla dhe a vlerësohen ato si efektivë?
- Buxheti: sa kërkon gjyqësori për vetëmenaxhim dhe vetëqeverisje financiare dhe sa i miratohet nga Kuvendi, çdo vit?
- Struktura dhe organika: sa burime njerëzore kërkojnë institucionet e qeverisjes së gjyqësorit, dhe sa u miratohet nga Kuvendi? Sa shtesa miratohen në vit?
- Sa kërkesa paraqiten në Gjykatë Kushtetuese nga subjekte të legjitimuara në mbrojtje të interesave të gjyqësorit, dhe a/sa pranohen nga kjo gjykatë?
- Sa është numri i vendimeve kundër ekzekutivit apo legjislativit, si tregues i fortë i pavarësisë së gjyqësorit dhe parimit të kontrollit e balancës?
- Sa mendojnë vetë gjyqtarët që janë të pavarur në aktivitetet gjyqësore?
- Sa mendojnë qytetarët që gjyqësori është dhe vepron si i pavarur?

- o Përdorni formularin e të drejtës për informim: <https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/04/kerkese-transparence.pdf>
- o Shih p.sh. Vjetorin Statistikor për të dhëna nga gjyqësori: <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/REPUBLIKA-E-SHQIP%C3%8BRIS%C3%8B-Vjetari-Statistikor-2021-pdf.pdf>

Pavarësia objektive është e lidhur me funksionimin struktural të gjyqësorit dhe ka këta nëntregues:

- garancitë formale të pavarësisë, të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj;
- garancitë formale, që gjyqtarët i binden vetëm ligjit;
- metodat formale mbi caktimin e pagave të gjyqtarëve;
- mekanizmat formalë për përshtatjen e pagave të gjyqtarëve;
- garancitë formale për përfshirjen e gjyqtarëve në zhvillimin e reformave ligjore dhe gjyqësore.

- o Shih p.sh. këtë opinion të Këshillit të Evropës: <https://rm.coe.int/16807481a1>

Autonomia organizative dhe financiare ka këta nëntregues:

- pozita formale e Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- përputhshmëria me udhëzimet e Rrjetit European të Këshillave Gjyqësorë;
- përgjegjësitë dhe kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- ndikimi i gjyqtarëve në vendimet e Këshillit;
- buxheti i Gjyqësorit, amendimet e tij, dhe zgjidhja e konflikteve mbi buxhetin.⁸

Pavarësia personale dhe paanësia e gjyqtarëve vlerësohet më së pari referuar pavarësisë dhe paanësisë së gjyqtarit, KPC dhe KPP. Elementet e paanësisë objektive dhe subjektive janë tregues të realizimit të procesit të rregullt. Tregues të tjerë janë:

- përzgjedhja, emërimi dhe shkarkimi i gjyqtarëve;
- përputhshmëria e udhëzimeve të Rrjetit European të Gjyqtarëve mbi emërimin e gjyqtarëve;
- vlerësimi, promovimi dhe shkarkimi i gjyqtarëve.

Masat disiplinore me këta tregues:

- përputhshmëria e standardeve të Rrjetit European të Gjyqtarëve lidhur me masat disiplinore ndaj gjyqtarëve;
- organi kompetent për marrjen e vendimeve ndaj masave disiplinore;
- mostransferimi i gjyqtarëve me këta nëntregues:
- garanci formale për mostransferimin; parashikime mbi transferimin pa pëlqimin e tyre.

8. Ibid, Raporti i RREKGj-së “Pavarësia, llogaridhënia dhe cilësia e Gjyqësorit, Indikatorët e Performancës”, 2017, fq.15.

Pavarësia e brendshme, sipas këtyre nëntreguesve:

- ndikim nga gjyqtarët më të lartë;
- mundësia efektive e përdorimit të udhëzimeve;
- ndikimi nga administratorët/drejtuesit e gjykatës.⁹

Lidhur me parashikueshmërinë, metoda e matjes për standardet e realizimit të pavarësisë objektive dhe subjektive, duhet të fokusohet në:

- Analizën e kuadrit juridik mbi pavarësinë organizative dhe financiare në raport me situatën faktike organizative dhe financiare, që rezulton për zbatimin e kuadrit juridik të financimit të gjyqësorit nga Kuvendi.
- Krahasim mes buxheteve vjetore të miratuara, dhe atyre të kërkuara sipas nevojave. Statistika dhe analiza mbi kërkesat e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese nga subjektet e legjitimuara dhe pranimi apo refuzimi i këtyre kërkesave, me pretendime të lidhura me ndarjen dhe balancimin e pushteteve, me pavarësinë e gjykatave, me paanësinë e gjyqësorit.
- Sondazhe të opinionit publik mbi perceptimin që ata kanë mbi pavarësinë e gjyqësorit, sipas standardeve të CEPEJ-së.¹⁰ Perceptimi i pavarësisë në sistemin kombëtar sipas opinionit publik, bazuar në Indeksin Global të Shtetit të së Drejtës, 2016.
- Raporte të autoriteteve ndërkombëtare mbi pavarësinë dhe korrupsionin (politik, financiar) si element varësie¹¹, si (Progres) Raportet e Komisionit Evropian, sondazhe të ndryshme kombëtare mbi korrupsionin dhe besimin e qytetarëve tek institucionet e shtetit, përfshirë pushtetin gjyqësor¹².

Kriteret e vlerësimit të cilësisë së vendimeve gjyqësore do të jenë:¹³

- Sa të hapura dhe transparente, dhe në përputhje me parimet kryesore proceduriale (kontradiktoritetin, barazinë e armëve, të drejtat e mbrojtjes), kanë qenë dëgjimi dhe vlerësimi që u ka bërë gjykata pretendimeve të palëve?
- Sa e kuptueshme, e qartë dhe e thjeshtë ka qenë gjuha me të cilën është shkruar vendimi?
- Sa i pajtueshëm është vendimi me jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe standardet dhe kriteret e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut?
- Sa merr në konsideratë vendimi gjyqësor, përveç koncepteve ligjore, edhe ato realitete të jashtme jo-ligjore, si p.sh. konsideratat etike, ekonomike dhe shoqërore?

9. *Ibid*, fq.16.

10. Grupi i Punës për Cilësinë e Drejtësisë i Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë së Këshillit të Evropës (CEPEJ-GT-QUAL), Raporti “Si të zhvillojmë sondazhe mbi nivelin e kënaqshmërisë së përdoruesve të gjykatave në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës» (CEPEJ 2010-2).

11. CM/Res (97) 24 Mbi njëzet parimet udhëzuese për luftën kundër korrupsionit. Shih: <https://rm.coe.int/16806cc17c>

12. GRECO, Parandalimi i Korrupsionit, përfundime dhe tendenca, 4th Evaluation Round, fq.17-25.

13. Opinioni nr.11/2008 i CCJE.

Metodat e matjes përfshijnë:

- Kontrolli gjyqësor i vendimmarrjes brenda vetë sistemit kombëtar të së drejtës. Analiza e vendimmarrjeve gjyqësore nga gjykata më e lartë për më të ultën, sipas pretendimeve procedurale të palëve.
 - Nxjerrja e vendimeve njehsuese të Gjykatës së Lartë është tregues i interpretimit ligjor nga gjykatat/gjyqtarët në mënyrë të qartë dhe të parashikueshëm.
 - Të dhëna dhe statistika mbi shfuqizimin e vendimeve nga gjykatat më të larta për ato më të ultat, mbi këtë standard performance, pra parashikueshmëria e vendimeve gjyqësore dhe siguria juridike. Mbikëqyrje dhe analiza mbi vendimet njehsuese të Gjykatës së Lartë dhe roli i tyre në kuadër të sigurisë juridike.
 - Sondazhe dhe anketime me opinionin publik mbi vendimmarrjen gjyqësore dhe perceptimin publik d.m.th. me pranimin e tyre si të drejta nga opinioni publik dhe shoqëria, e lidhur me besueshmërinë, ose legjitimitetin e vendimeve gjyqësore.¹⁴
- o Shembull i tillë nga Kosova është: <https://rm.coe.int/analiza-e-rezultateve-te-anketave-te-kenaqshmerise-se-perdoruesve-te-g/16808d3c39>

Për *imunizimin "socio-politik"* tregues janë:

- Garantimi formal i imunizimit të gjyqtarit, përmes parametrave ligjorë, infrastrukturës organizative të ushtrimit të funksionit, lëvizjes, karrierës së gjyqtarit. Ky tregues është i lidhur me pavarësinë dhe llogaridhënien.
- Garantimi i kushteve ekonomike-sociale të gjyqtarit sipas ligjit për statutin e magistratëve.
- Garantimi i kushteve të përshtatshme të punës, që i krijojnë komoditet në ushtrimin e funksionit.
- Garantimi i kushteve dhe i kriterëve ligjore për të realizuar me efikasitet shqyrtimin e çështjeve gjyqësore.

Për treguesit e realizimit të imunizimit socio-politik të gjyqtarit mund të bëhen pyetje të tilla, si:

- Sa garantues është Kushtetuta dhe ligji për statusin e gjyqtarit, por edhe ligjet e tjera procedurale dhe materiale, ndaj pavarësisë dhe panësisë së gjyqtarit?
- Sa garantues është statusi i gjyqtarit për garantimin e profesionit, palëvizshmërinë në detyrë dhe vazhdimësinë e karrierës së tij?
- Sa garantuese është paketa sociale dhe ekonomike e gjyqtarit ndaj ndërhyrjeve?
- Sa të duhura dhe të përshtatshme janë kushtet e punës së gjyqtarit?
- Sa miqësor/armiqësor është ambienti politik ndaj gjyqësorit/ndaj gjyqtarit?

14. Shih për anketimet orientimet e: https://rm.coe.int/komisioni-evropian-per-efikasitetin-e-drejtises-cepej-matja-e-cilesis/16807477ca#_Toc473457927

- Sa vulnerabël është gjyqësori/gjyqtari ndaj presionit politik?
- Sa vulnerabël është gjyqtari ndaj mediatizimit të punës dhe rolit të tij në një çështje konkrete?
 - o Shembuj:
 - <https://klgj.al/wp-content/uploads/2021/09/Opinion-P%C3%ABr-standardet-etike-t%C3%AB-zbatueshme-n%C3%AB-rastin-e-p%C3%ABrdorimit-t%C3%AB-mediave-sociale-nga-gjyqtar%C3%ABt.pdf>

Metoda e matjes për këto tregues përfshin:

- Analizë të statusit të gjyqtarit shqiptar krahasuar me standardet ndërkombëtare të kërkuara¹⁵.
- Hulumtim i situatës faktike dhe nivelit të zbatimit të ligjit për statusin e gjyqtarit, mbi parametrat ligjorë, ekonomikë dhe socialë garantues të këtij imuniteti.
Shënim: Shih për një vlerësim të statusit të një gjyqtari këtë shembull <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/12/VENDIM-Nr.537-dat%C3%AB-14.12.2022-P%C3%8BR-VLER%C3%8BSIMIN-ETIK-DHE-PROFESIONAL-T%C3%8BGJYQTARES-%E2%80%A6-P%C3%8BR-VITIN-2021.pdf>
- Vlerësim të vulnerabilitetit të gjyqtarit ndaj ndërhyrjeve dhe korrupsionit, sipas Indekseve të GRECO¹⁶.
- o Shih një shembull të vlerësimit të sistemit gjyqësor “THE EBRD JUDICIAL DECISIONS ASSESSMENT FOR ALBANIA, BULGARIA, BOSNIA AND HERZEGOVINA CROATIA, THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA, KOSOVO, MONTENEGRO, ROMANIA, SERBIA AND SLOVENIA THE REGION SUMMARY”, në <https://www.ebrd.com/documents/legal-reform/judicial-decisions-assessment-regional-summary-2010.pdf>

15. Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, vlerësohet se i plotëson këto standarde *de jure*. Gjithsesi vendimi i GjK-së nr.41, datë 16.05.2017 ka shfuqizuar disa nene; 5, 61, 103, 159 dhe 169, pika 5 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nën dritën e standardeve ndërkombëtare të garancive të magjistratit, për shkaqet dhe ankim ndaj masave disiplinore.

16. Shih: http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/index_en.asp. dhe <https://rm.coe.int/greco-rc4-2018-4-raundi-i-katert-i-vleresimit-parandalimi-i-krimet-ne-/16808c439b>

MODULI 3

SISTEMI I VLERËSIMIT TË GJYQTARËVE TË EMËRUAR NË DETYRË SI DHE STANDARDET E PERFORMANCËS SË GJYQTARIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor thekson se sundimi i ligjit në demokraci kërkon jo vetëm pavarësinë e gjyqësorit, por edhe krijimin e gjykatave kompetente që japin vendime gjyqësore të cilësisë më të lartë të mundshme. Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropiane (CCJE) u ka kushtuar vëmendje të vazhdueshme dy çështjeve themelore. Së pari, mbrojtja e pavarësisë gjyqësore dhe së dyti, mënyrat për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të sistemeve gjyqësore. Vlerësimi individual i gjyqtarëve është i rëndësishëm për të dyja këto çështje. Në këtë Opinion, shprehja “vlerësimi individual i gjyqtarëve”, përfshin vlerësimin e punës profesionale të gjyqtarëve individualë dhe aftësive të tyre.¹⁷

Pse duhet vlerësimi? Vlerësimi i gjyqtarëve ndërmerret për të vlerësuar:

- aftësitë e gjyqtarëve individualë dhe
- cilësinë e sasinë e detyrave që ata kanë kryer.

Vlerësimi përdoret, për shembull:

- për të siguruar të dhëna,
- për të identifikuar nevojat e trajnimit dhe
- për të përcaktuar rrogat “e bazuara në performancë”
- Po ashtu, mund të përdoret për të gjetur kandidatët e përshtatshëm për ngritje në detyrë.

Ka argumente se, përmes këtyre mënyrave, vlerësimi individual, në parim, mund të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së sistemit gjyqësor dhe kështu mund të sigurojë llogaridhënien e duhur të gjyqësorit ndaj publikut.¹⁸

Vlerësimi është:

- Formal
- Informal

17. <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/01/Opinion-No.-17-2014-shqip.pdf>

18. Po aty.

- I. Formal: në rastin e vlerësimeve më formale, qëllimet e vlerësimit, kriteret e përdorura, përbërja e trupit vlerësues, procedura për vlerësimin dhe pasojat e tij të mundshme janë të vendosura të gjitha në mënyrë të qartë përpara çdo ushtrimi të vlerësimit. Nëse vlerësimi kryhet në mënyrë të tillë formale, të drejtat dhe detyrat e gjyqtarit të vlerësuar dhe trupi i vlerësimit do të rregullohen me anë të legjislacionit parësor apo akte nënligjore.
- II. Informal: Një vlerësim informal nuk do të përdorë as pikëzim, as kriteret të formalizuara. Zakonisht, nuk do të ketë pasoja të drejtpërdrejta për gjyqtarin e vlerësuar. Një vlerësim informal mund të bëhet me anë të një diskutimi që do t'i lejojë gjyqtarit që vlerësohet t'i trajtojë problemet, të tregojë aftësitë e veta dhe të pajtohet për qëllimet e karrierës. Mbledhja informale e informacionit rreth një gjykatësi që është kandidat për ngritje në detyrë mund të konsiderohet po ashtu si vlerësim informal.¹⁹

Shqipëria vlerëson gjyqtarët në përputhje me ligjin nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas këtyre kriterëve:

- AFTËSITE PROFESIONALE
- AFTËSITË ORGANIZATIVE
- ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE
- AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Niveli i vlerësimit të gjyqtarit përcaktohet për çdonjërin nga katër kriteret e vlerësimit dhe përcaktohet mbi bazën e një shkalle pikëzimi nga 1 deri në 100 pikë. Shkalla e pikëzimit që përcakton nivelet e vlerësimit është:

- 90 deri 100 pikë "Shkëlqyeshëm";
- 70 deri 89 pikë "Shumë mirë";
- 50 deri në 69 pikë "Mirë";
- 30 deri në 49 pikë "Mjaftueshëm" dhe;
- 1 deri në 29 pikë "Pamjaftueshëm"²⁰

Qëllimet:

- cilësia e gjyqtarëve;
- ngritja në detyrë: CCJE dhe OKB kanë deklaruar se emërimi dhe ngritja në detyrë e gjyqtarëve nuk duhet të bazohet vetëm në vjetërsi, por në kriteret objektive, në aftësinë e veçantë, integritetin dhe përvojën;
- shpërblimi dhe disiplina: një emërim i përhershëm nuk duhet të ndërpritet thjesht për shkak të një vlerësimi të pafavorshëm. Duhet të ndërpritet vetëm në një rast të shkeljeve të rënda të dispozitave disiplinore ose penale të përcaktuara me ligj ose kur përfundimi i pashmangshëm i procesit të vlerësimit është se gjyqtari është i paaftë apo nuk ka dëshirë

19. Po aty.

20. Shih Metodologjinë e miratuar nga KLGj-ja; <https://klgj.al/wp-content/uploads/2019/12/Metodologjia-e-pikezimit-material-MB-Pl-referuar-Vendimit-Nr.-264.pdf>

për të kryer detyrat e tij/saj gjyqësore me një standard minimal të pranueshëm, të gjykuar objektivisht.

Më tej ndalemi te standardet e performancës së gjyqtarit, me fokus te procedimi disiplinor.

Palëvizshmëria dhe qëndrimi në detyrë janë faktorë kyç për pavarësinë e gjyqtarit. Megjithatë, rëndësia e pushtetit gjyqësor dhe pasja besim e publikut në të, detyrojnë përcaktimin e mekanizmave llogaridhënës për anëtarët e gjyqësorit. Kjo qasje përfshin regjimin disiplinor ndaj gjyqtarëve, deri në shkarkimin e tyre, të cilët janë të papërshtatshëm për profesionin që ushtrojnë.²¹

Procedimi disiplinor mund të fillojë nëse gjyqtarët nuk i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efikase dhe të duhur. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur:

- a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës;
- b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur:

- a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një veprë penale;
- b) merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;
- c) kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit²².

Këshilli mund të vendosë një ose më shumë nga këto masa disiplinore:

- a) vërejtje konfidenciale;
- b) vërejtje publike;
- c) ulje e përkohshme e pagës:
 - i) deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit;
 - ii) në rastin e magjistratëve që kanë dhënë dorëheqjen, gjobë në një masë të barabartë me uljen e përkohshme të pagës;
- ç) ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër;
- d) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave;
- dh) shkarkim nga detyra²³.

21. ENCJ, Raporti, Zhvillimi i standardeve minimale gjyqësore [*Development of minimum judicial standards*] V 2014-2015, miratuar në Hagë, më 5 qershor 2015, fq.5.

22. Neni 140 i Kushtetutës.

23. Neni 105 i ligjit nr. 96/2016.

Ligji ka parashikuar tri kategori shkeljesh disiplinore:

1. *gjatë* ushtrimit të funksionit gjyqësor;²⁴
2. *gjatë ose në lidhje* me ushtrimin e funksionit, *brenda ose jashtë* zyrës;²⁵
3. *jashtë* ushtrimit të funksionit.²⁶

Inspektorati i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve. ILD është i vetmi autoritet përgjegjës për hetimin disiplinor ndaj të gjithë gjyqtarëve, duke filluar nga marrja dhe verifikimi i ankesës, për të vijuar me hetimin disiplinor dhe finalizimin e procesit me fillimin e procedimit disiplinor përpara Këshillit përkatës - KLGj për gjyqtarët²⁷.

Kryetari i Gjykatës mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore dhe të solemnitetit, si dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, si dhe mbikëqyr disiplinën në punë të gjyqtarëve dhe kërkon fillimin e hetimit kur dyshohet shkelje disiplinore e gjyqtarëve në gjykatat e tyre²⁸.

Indikatorët e performancës

Ka dy lloj treguesish të realizimit: objektivë dhe subjektivë. Treguesit objektivë duhet të konsiderohen ata që janë të lidhur strukturalisht me gjyqësorin dhe ata të lidhur individualisht me gjyqtarin. Regjimi disiplinor nuk është i mjaftueshëm vetëm për gjyqësorin si i tërë, por edhe për gjyqtarët individualisht. Përgjegjësia është e dyanshme: kolektive dhe individuale.²⁹

Treguesit objektivë të realizimit janë:

- Miratimi i një Kodi të Sjelljes Gjyqësore, i cili e bën llogaridhënës gjyqtarin para opinionit publik për jetën e tij profesionale dhe personale;
 - *Shënim: shih për shembull Kodin Etik në https://www.gjykataelarte.gov.al/web/kodi_i_etikes_gjyqesore_1754.pdf
- Procedura ankimi ndaj gjyqtarit, në rast se pretendohet mbi shkaqe të pranueshme sjellja e tij joetike dhe profesionale;
 - pjesëmarrje aktive e përfaqësuesve nga jashtë sistemit, që e bën gjyqtarin llogaridhënës;

24. *Ibid*, neni 102/1.

25. *Ibid*, neni 102/2.

26. *Ibid*, neni 103.

27. *Ibid*, neni 194.

28. Neni 39 i ligjit nr. 98/2016.

29. *Ibid*, ENCJ, Raporti - Zhvillimi i standardeve minimale gjyqësore V 2014-2015 [Report - Development of minimum judicial standards V 2014-2015] miratuar Hagë, 5 qershor 2015, fq.13, dhe ENCJ Deklarata mbi Vetëqeverisjen për Gjyqësorin: Balancimi i Pavarësisë dhe Përgjegjshmërisë [Declaration on Self Governance for the Judiciary: Balancing Independence and Accountability], Budapest (2008).

- apelim ndaj vendimit që mund të ketë vendosur në favor të gjyqtarit;
- numri i ankimeve, që mund të tregojë deri ku është niveli i llogaridhënies në gjyqësor;
- numri i sanksioneve;
- kohëzgjatja e këtyre ankimeve dhe qasja pro aktive penalizuese e organeve kompetente disiplinore iniciuese të procesit, si dhe vendimmarrëse, ndaj sjelljes së gjyqtarëve;

*Shënim: shih për shembull:

<https://ild.al/wp-content/uploads/2020/10/Urdher-nr.-65-date-28.09.2020.pdf>

<https://ild.al/wp-content/uploads/2020/11/Urdher-Nr-104-date-23.11.2020.pdf>

- Transparenca për kodet etike, udhëzimet si dhe aktivitetet e lidhura me proceset disiplinore ndaj gjyqtarëve, informim dhe akses i publikut dhe Medias.

*Shënim: shih për shembull:

<https://ild.al/wp-content/uploads/2020/10/Urdher%20nr.%2071%20-%2001.10.2020%20.pdf>

Shih edhe:

<https://klgj.al/wp-content/uploads/2019/12/Metodologjia-e-pikezimit-material-MB-PI-referuar-Vendimit-Nr.-264.pdf>

Metoda e matjes

Metoda e matjes përfshin:

Statistikat e prodhuara nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë dhe KLGj (Komisioni Disiplinor), të cilat mund të nxjerrin konkluzione dhe përfundime mbi standardet e llogaridhënies dhe regjimit disiplinor. Po ashtu, anketime me ekspertë dhe profesionistë të specializuar që njohin sistemin gjyqësor, lidhur me përthithjen e opinionit të tyre mbi llogaridhënien e gjyqësorit dhe gjyqtarëve.

Treguesit subjektivë kërkojnë ekzistencën e sondazheve për përthithje opinionit mes grupeve të ndryshme në shoqëri mbi krijimin dhe funksionimin e kulturës së llogaridhënies nga gjyqtarët dhe gjyqësori.

EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI PËRKATËS

Shembuj:

Neni 136/a i Kushtetutës:

1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.
2. Krite të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj.

Neni 28, shkronja “d”, i ligjit nr. 96/2016:

Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magistrat, nëse përmbush kriterin e mëposhtëm:

d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë.

KODI I ETIKËS GJYQËSORE (2021)

.....

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Standardet e etikës gjyqësore dhe rregullat e sjelljes të gjyqtarit, në vijim “Kodi i Etikës Gjyqësore”, janë tërësia e parimeve, normave dhe rregullave, të cilat udhëheqin sjelljen e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe veprimtarisë së tij jashtëgjyqësore.
2. Kodi i Etikës Gjyqësore synon të garantojë rritjen dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe dhënien e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën, standardet e njohura ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut dhe ligjin.
3. Gjyqtari duhet të ruajë dhe të zbatojë standarde të larta të sjelljes dhe duhet t’i respektojë personalisht këto standarde, në mënyrë që integriteti dhe pavarësia e gjyqësorit të ruhen. Dispozitat e këtij Kodi duhet të interpretohen dhe të zbatohen për të arritur këtë objektiv.

.....

RASTE STUDIMORE

RASTI 1

Në media botohet një shkrim që pasqyron se një deputet i ka shkruar një gjyqtari duke e informuar për interesimin e tij, në emër të një zgjedhësi, për një rezultat të shpejtë dhe të drejtë në çështjen e divorcit dhe të kujdestarisë së zgjedhësit. Gjyqtari iu përgjigj duke informuar deputetin - personalisht (ose, nëpërmjet gjyqtarit të shtypit) - që parimet e sjelljes së duhur gjyqësore dhe konkretisht parimi i pavarësisë, e ndalojnë atë të marrë parasysh ose t'i përgjigjet një komunikimi të tillë.

Shtrirja e ndalimit përfshin:

- a) përgjigjen ndaj interesimit të deputetit në lidhje me statusin e një çështjeje;
- b) datën kur mund të merret një vendim;
- c) vetëpërmbajtjen e vendimit. Nëse ky informim i gjyqtarit për deputetin nuk ndodh, atëherë krijohet dukja, perceptimi, pamja se deputeti është në gjendje të ndikojë te gjyqtari që të përshpejtojë një vendim dhe në këtë mënyrë të ketë konsiderata preferenciale për një palë ndërgjyqëse.³⁰

- Pyetje për diskutim

- o A vlerësoni se gjyqtari ka mbajtur qëndrimin e duhur ligjor?
- o A duhet kthyer përgjigje në raste të tilla? Nëse po, deri në ç' nivel mund të jepen informacionet dhe nga kush?
- o A vlerësoni se kemi të bëjmë me një rast shkeljeje disipline?

30. United States of America, Commonwealth of Virginia Judicial Ethics Advisory Committee, Opinion 2000-7.

RASTI 2

Gjyqtarja po gjykon një rast me objekt zgjidhjen e martesës, ku palët janë problematike në komunikim, në paraqitjen e provave apo dhe thirrjen e pranimit të ekspertëve. Kjo ka bërë që gjykimi i çështjes të zgjasë. Në një nga seancat e radhës, pala paditëse u shpreh në adresë të gjyqtarës se, “nuk mund të gjykojë këtë çështje, pasi nuk është nënë vetë dhe ka marrë para nga pala e paditur përderisa gjykimi vazhdon kaq gjatë”. Gjyqtarja ka hequr dorë nga gjykimi, pasi është ndier personalisht e fyer dhe ka pohuar se nga ky moment ajo nuk mund të gjykojë si e paanshme.

- Pyetje për diskutim

- o Cili është standardi të cilit i referohet pala paditëse?
- o A vlerësoni se jemi para rastit të konfliktit të interesave?
- o A duhet të hiqte dorë gjyqtarja nga gjykimi?

RASTI 3

Gjyqtari sapo është emëruar kryetar i Gjykatës. Ai është i kënaqur me punën që bën si gjyqtar dhe krenar me pozitën e re. Meqenëse gjyqtari në fundjavë ka ditëlindjen, ka vendosur të ftojë sa më shumë shokë dhe miq, të vjetër dhe të rinj, për të festuar në shtëpinë e tij. Ditën e lindjes, shokët dhe miqtë e fakultetit dhe të jetës, si avokatë, prokurorë dhe gjyqtarë, disa prej të cilëve shpesh paraqiten në gjykatë, erdhën në shtëpinë e magjistratit, plot me lule dhe dhurata. Në festën e “dy gëzimeve”, me hare dhe muzikë, nuk munguan ushqimi, vera, rakia, dollia dhe dhuratat e shtrenjta. Kryetari/gjyqtar me gotën e rakisë në dorë, shkante në çdo tavolinë ku përshëndetej, këndonte, kërcente dhe bënte fotografi. Festimi i ditëlindjes ishte sukses i madh, që duhej ndarë me shumë miq e shokë. Ndaj të nesërmen, Kryetari/gjyqtar postoi në Facebook fotografitë që ishin bërë. Kështu, miq e shokë të tjerë e panë superfestën e ditëlindjes, ku dhanë dhe pëlqime e komente pa fund.

- Pyetje për diskutim

- o Cili është standardi që mund të jetë cenuar në këtë rast?
- o A vlerësoni se duhet të organizohej në një mënyrë tjetër festa dhe të kish një tjetër sjellje në publikimin e fotove?
- o Ç’parashikon ligji apo Kodi Etik për një rast të tillë?

RASTI 4

Gjyqtarja, një ish-miss, mori gjithë vëmendjen e mediave, pas publikimit të disa videove të saj në një rrjet social me logon “Tik Tok”. Ajo kishte realizuar disa video ku shfaqej me sjellje dhe veprime provokuese, shoqëruar në sfond me muzikë të papërshtatshme për imazhin e një magjistrati, në ambientet e zyrës së saj dhe të gjykatës. Gjykata, institucioni ku pritet të vendoset drejtësi, u kthye në pasarelë sfilatash nga modelja gjyqtare. Në një tjetër video, ajo reklamonte veshjet e markave të shtrenjta dhe makinën tip “Audi”, madje në një moment ecën me shpejtësi dhe bën një parakalim të gabuar në rrugë duke dëgjuar në sfond këngën e Don Xhonit “Mafia”.

- Pyetje për diskutim

- o A vlerësoni se jemi para rastit të cenimit të ndonjë parimi apo standardi?
- o Cili është standardi apo parimi i cenuar në një rast të tillë?
- o Si e vlerësoni veprimin dhe, në gjykimin tuaj, ç’masë disiplinore jepet në një rast të tillë?

BIBLIOGRAFI

IPLS, Guide "Integriteti Gjyqesor", maj 2023

Akte rregullatore të vendit dhe të huaja

- Ligji Nr. 8417, Datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit"
- Ligji nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"
- Ligji nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"
- Ligj nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"
- Kodi i Procedurës Penale
- Kodi i Procedurës Civile
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm"
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 2.12.2020 "Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë"
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 6.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të Monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore"
- Lista e Kontrollit të Integritetit Gjyqësor, UNDP
- Parimet e Bangladorit
- Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të integritetit gjyqësor [Judicial Integrity Self-Assesment Checklist], Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, UNDP, 2018
- Qasja në drejtësi "Gjykatat" [Access to Justice "The Courts"] UNODC.
- Treguesite Shtetit të së Drejtës, OKB, Udhërrëfyes për zbatimin dhe mjetet projektuese, Edicion 1rë, 2011
- Rekomandimet e Kiev-it, Rekomandime për Pavarësinë Gjyqësore në Evropën Lindore, Kaukazin e Jugut dhe Azinë Qendrore [Recommendations on Judicial Independence in Eastern Europe, South Caucasus and Central Asia], 23-25 qershor 2010
- Judicial Reform Index, ABA Rule of Law Initiative
- Konventa e Këshillit të Evropës për Aksesimin e dokumenteve zyrtare, 18/06/2009.

- Rregullorja nr.1049/ 30 maj 2001 e (KE) “Mbi aksesin e publikut në dokumentacionin e Këshillit, Parlamentit dhe Komisionit Evropian”
- Rregullorja (BE) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 prill 2016 [2019], OJ L 119/1.
- Direktiva (BE) 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 Prill 2016 [2016], OJ L 119/89.
- Rregullorja (BE) 2018/1725 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2018 [2018], OJ L 295/39 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet, organet, zyrat e Bashkimit dhe agjencive dhe mbi lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla
- Vendimi Zbatues i Komisionit (BE) 2016/1250 i datës 12 korrik 2016 në përputhje me Direktivën 95/46/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi përshtatshmërinë e mbrojtjes së ofruar nga BE-SHBA
- Rekomandimi CM/Rec (2010)12, nr. 44
- Rekomandimi Nr. R (84) 5 i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi parimet e procedurës civile që përmirësojnë funksionimin e drejtësisë”
- Indeksi i Reformës në Drejtësi – ABA Iniciativa për Sundimin e Ligjit
- Rekomandimi Nr. R (2001) 2 i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës Mbi konceptimin dhe rikonceptimin e sistemeve gjyqësore dhe të informacionit ligjor.
- Rekomandimi Nr. (2001) 3 i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës Mbi lëvrimin e shërbimeve të gjykatave dhe shërbimeve të tjera ligjore përmes përdorimit të teknologjive të reja.
- Rekomandimi No. R (2001) 3 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Mbi ofrimin e shërbimeve gjyqësore dhe të shërbimeve të tjera ligjore përmes përdorimit të teknologjive të reja
- Rekomandimi nr. R (2003) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi arkivimin e dokumentave elektronikë në sektorin e drejtësisë”
- Rekomandimet e Opinionit Nr.4 (2003) të CCJE, “Për trajnimin e gjyqtarëve”
- Rekomandim **(2010)12 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi gjyqtarët: pavarësia, efica dha përgjegjësitë**
- Rekomandim (2010) 12 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare në lidhje me gjyqtarët: pavarësia, efica dha përgjegjësitë, Këshilli i Europës, 2010
- Lista e Kontrollit për Shtetin e së Drejtës, Komisioni i Venecias
- CEPEJ, 2016 (12), “Matja e cilësisë së drejtësisë”, 7 dhjetor 2016
- Lista kontrolluese për promovimin e cilësisë së drejtësisë dhe gjykatave, CEPEJ (2008)2
- CEPEJ, 2016, Udhëzues zbatimi “Drejt afateve europiane për proceset gjyqësore”
- Deklarata ENCJ Londër mbi Etikën Gjyqësore
- CEPEJ, Karta Etike Evropiane për Përdorimin e Inteligjencës Artificiale në Sistemet Gjyqësore dhe mjedisin e tyre”, Strasburg, 3-4 dhjetor 2018.
- Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion nr. 19 (2016), “Roli i Kryetarëve të Gjykatave
- Opinioni nr.19 (2006), CCJE, “Mbi rolin e Kryetarëve të Gjykatave”

- Opinioni nr.403/2006/, 16-17 mars 2007, i Komisionit të Venecias “Për emërimet gjyqësore”
- Opinioni nr.11/2008 i CCJE.
- Opinioni nr.14, (2011) të CCJE.
- Opinioni nr. 7/2005 i CCJE.
- Opinioni nr. 3 në vëmendjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Parimet që Drejtojnë Sjelljen Profesionale të Gjyqtarëve, në veçanti Etika, Sjellja e Papajtueshme dhe Paanshmëria, CCJE, 2002
- Opinioni nr.19 (2006), “Mbi rolin e Kryetarëve të Gjykatave”, CCJE
- Standardet e SATURN, CEPEJ, Eficenca dhe efikasiteti në sistemin gjyqësor, Këshilli i Evropës
- SATURN, Udhëzime për menaxhimin e kohës gjyqësore, CEPEJ- SATURN, 2015
- Karta Evropiane të Statutit të Gjyqtarëve
- Opinion nr.179, (2014) i CCJE “Për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, cilësisë së drejtësisë, dhe respektimit të pavarësisë gjyqësore”
- Opinioni 17 (2014), para. 46 i CCJE-së.
- Opinion nr. 17 (2014) “Për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, cilësisë së drejtësisë dhe respektimin e pavarësisë gjyqësore” i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian
- Global Measures of Court Performance

Botime dhe analiza

- Advocacy Toolkit, Lufta kundër korrupsionit në sistemin gjyqësor [*Combating Corruption in Judicial System*], Transparency International, The global Coalition Against Corruption
- CEPEJ, “Doracak për kryerjen e anketave të kënaqësisë që synojnë përdoruesit e gjykatave në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës [*Handbook for conducting satisfaction surveys aimed at court users in Council of Europe’s member states*].

Raporte

- ENCJ, Raport për Pavarësinë, Përgjegjshmërinë dhe Cilësinë e Gjyqësorit – Treguesit e Performancës [*Report on Independence, Accountability and Quality of the Judiciary – performance indicators*], miratuar nga Asambleja e Përgjithshme Paris, 9 qershor 2017, 2017,
- Raporti i ENCJ, Pavarësia, llogaridhënia dhe cilësia e Gjyqësorit, Indikatorët e Performancës, 2017
- Raporti i RREKGj-së “Pavarësia, llogaridhënia dhe cilësia e Gjyqësorit, Indikatorët e Performancës”, 2017
- GRECO, Parandalimi i Korrupsionit, përfundime dhe tendenca, 4th Evaluation Round
- ENCJ, Raporti, Zhvillimi i standardeve minimale gjyqësore [*Development of minimum judicial standards*] V 2014-2015, miratuar në Hagë, më 5 qershor 2015
- Raport 2012-2013 i Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësore (ENCJ) për standardet minimale lidhur me vlerësimin e performancës profesionale dhe mosheqjen nga detyra të anëtarëve të gjyqësorit

Vendime të GjK-së të RSh-së

- Vendim nr. 77/2000
- Vendim nr. 25/2003
- Vendim nr. 11/2004
- Vendim nr. 17/2005
- Vendim nr. 16/2006
- Vendim nr. 38/2007
- Vendim nr. 25/2008
- Vendim nr. 11/2008
- Vendim nr. 14/2006
- Vendim nr. 7/2008
- Vendim nr. 23/2008
- Vendim nr. 8/2010
- Vendim nr. 2/2011
- Vendim nr. 14/2010
- Vendim nr. 11/2010
- Vendim nr. 5/2012
- Vendim nr. 41/2013
- Vendim nr. 21/2022

Vendime të GjEDNj-së

- Gjonboçari kundër Shqipërisë, datë 31 mars 2005
- Hirvisaari kundër Finlandës, 27 shtator 2001
- Van de Hurk kundër Hollandës, 19 prill 1994
- Cocchiarella kundër Italisë, nr. 64886/01, 29 mars 2006
- Dobbartin kundër Francës, nr. 13089/87, 25 shkurt 1993
- Capuano kundër Italisë, nr. 9381/81, 25 qershor 1987
- Lechner dhe Hess kundër Austrisë, nr. 9316/81, 23 prill 1987
- Probstmeier kundër Gjermanisë, nr. 20950/92, 1 korrik 1997
- Gnahoré kundër Francës, nr. 40031/98, 19 shtator 2000
- Siałkowska kundër Polonisë, nr. 8932/05, 22 mars 2007

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore

Integriteti gjyqësor : manual trajnimi për shoqërinë civile :
standardet ligjore, parimet deontologjike, sistemi i vlerësimit
dhe i disiplinimit / Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore.

- Tiranë : Muza, 2023.

[V.]1, ... f. ; ... cm.

Bibliogr..

ISBN 9789928361516

1.E drejta dhe legjislacioni 2.Gjykata 3.Etika

ligjore 4.Manuale

340.132 (035)